

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "BELLE VUE" SH.P.K)

Sot, më datë 08 Mars 2021 (dymijë e njëzet e një), ditë e Hënë, ne palët kontraktuese:

PALA SHITËSE:

Z. Genc ETHEMI, atësia Nuredin, me shtetësi Kosovare, i datëlindjes 02.04.1984, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, me adresë, Emshir, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin Id Nr. 1084296 dhe nr. personal 1001195073. (në cilësinë e shitësit të një kuote të Shoqërisë "Belle VUE" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "**Shitës**").

PALA BLERËSE:

Zj. Alketa DANI, atësia Maksim, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Artan Lenja", Njësia Administrative nr. 7, e datëlindjes 13.06.1982, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me letërnjoftimin nr. 034595736 dhe nr. personal I25613067R. (në cilësinë e Blerësit të një kuote kapitali të Shoqërisë "Belle VUE" Sh.p.k., (këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Blerës**.)

Ne palët e sipërcituar me vullnetin tonë të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", biem dakord për hartimin e Kontratës së Shitjes të kuotës së kapitalit të Shoqërisë "Belle Vue" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT


1.1 Shoqëria "**Belle Vue**" sh.p.k, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar si person juridik në QKR (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) me numër Unik Identifikimi të subjektit M01316044C, e themeluar më datë 18.12.2019 dhe e regjistruar më datë 16.01.2020, me seli në Tiranë, Kashar, rruga "3 Dëshmorët", Pallati "Aleksandros", kati i parë, Yzberish, me objekt veprimtarie "Shitje me pakicë e artikujve elektroshtëpiakë, pajisje pastrimi, filtra uji, etj.


1.2 Shoqëria përbëhet nga dy ortakë janë si më poshtë:

- Objekt i kësaj kontrate është *Shitja* nga ana e *Shitësit* dhe *Blerja* nga ana e *Blerësit* e një kuote, që i përket 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Belle Vue**" Sh.p.k., që i korrespondon vlerës 50'000 Lekë.

1.3 *Shitja* e kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie nga ana e *shitësit* në masën 50 % gjithsej dhe *Blerja* nga ana e *Blerësit* e kuotës së kapitalit gjithsej 50 %, si më sipër, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së *Shitësit* mbi këtë kuotë dhe transferimin me të drejta të plota tek *Blerësi*, ku bëhet pronar i vetëm i një kuote në masën 100 % të kapitalit të shoqërisë, si pasojë e këtij trasanksioni shitje.

1.4 Në këtë mënyrë, me kalimin e pronësisë me anë të kësaj Kontrate *Shitje* të kuotës së kapitalit të Shoqërisë "**Belle Vue**" Sh.p.k. gjendja e pronësisë së kuotës ndryshon në këtë mënyrë:

Alketa Dani 

GENC ETHEMI


Shitësi Gene ETHEMI humbet tërësisht pronësinë mbi kuotën e kapitalit që shet dhe Blerësja Zj. Alketa Dani, bëhet pronare dhe zotëruese e një kuote kapitali, të përbërë nga 50 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 50'000 lekë. Me kalimin e pronësisë Alketa DANI, bëhet pronare e vetme e kuotës së kapitalit në masën 100 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 100'000 Lekë.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare **50'000 Lekë (pesëdhjetë mijë Lekë).**

2.2 Palët deklarojnë se nga ana e Blerësit vlera monetare e sipërcituar prej **50'000 Lekë (pesëdhjetë mijë Lekë)**, është shlyer totalisht dhe pala shitëse nuk ka asnjë pretendim as tani as në të ardhmen.

NENI 3

BAZA LIGJORE

3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*";

NENI 4

KALIMI I PRONËSISË

4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, *Shitësi* e humbet pronësinë e tij mbi kuotën e kapitalit zotërues që shet, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë kuotë në shoqërinë "*Belle Vue*" *Sh.p.k.*. Ndërsa Blerësi bëhet pronar i vetëm dhe i ligjshëm i kësaj kuote, duke e zotëruar atë tërësisht.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1 Pas shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë nga *Shitësi* tek *Blerësi*, kjo e fundit ka të drejtë ta regjistrojë kontratën në QKB (*Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit*), për të bërë ndryshimet përkatëse.

5.2 Nga informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, në rezultatet e kërkimit sipas shkresës bashkëngjitur kësaj kontrate; rezulton se Shoqëria "*Belle Vue*" *Sh.p.k.*, si dhe ortakët e saj **është e lirë nga çdo barrë e hipotekë mbi kotën e kapitalit.**

5.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, *Shitësi* humbet çdo të drejtë pronësie si dhe çdo të drejtë tjetër për sa i përket pjesës së kuotës të kapitalit të shoqërisë që i kalon *Blerësit*, duke i kaluar atij çdo të drejtë dhe përgjegjësi mbi Shoqërinë.

5.4 *Blerësi*, ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të respektojë dispozitat përkatëse për njohjen e shoqërisë, duke marrë përsipër dhe duke njohur çdo të drejtë dhe detyrim të shoqërisë kundrejt të tretëve, si aktivin ashtu edhe pasivin e saj.

NENI 6

REGJISTRIMI NË QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE

6.1 Palët deklarojnë se morën dijëni për kryerjen e regjistrimit të këtij transaksioni pranë QKB-së (*Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve*) Tiranë, për të bërë ndryshimet përkatëse pas nënshkrimit të kësaj kontrate në bazë të Ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

Alketa

Dani



Gene ETHEMI
g. ethemi

NENI 7

INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

7.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

7.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

NENI 8

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

8.1 Kjo kontratë, është hartuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705 e vijues të tij si dhe Ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

8.2 Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e tjera të Kodit Civil dhe në Legjislacionin përkatës.

8.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

8.4 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej tyre mund t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 9

ANEKSET E KONTRATËS

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 1, datë 08.03.2021;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "Belle Vue" Sh.p.k., datë 08.03.2021;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 10

GJUHA E HARTIMIT TË KONTRATËS

10.1 Kontrata u hartua në gjuhën shqipe prej palëve kontraktuese në 4 (katër) kopje, e përbërë nga 4 (katër) fletë secila, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje depozitohet në QKB-së (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) për t'u regjistruar transaksioni i kryer dhe dy kopje të tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

NENI 11

HYRJA NË FUQI

11.1 Kjo Kontratë Shitje kuote e kapitalit hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit të palëve.

Alketa

Dani

GENC ETHEMI
Gethemi


NENI 12

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

12.1 Kontrata e Shitjes të kuotës së kapitalit u lexua nga ne palët me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin tonë të lirë e të plotë, u njohëm dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajmë atë rregullisht pa vërejtje.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE
Genc ETHEMI

GENC ETHEMI


PALA BLERËSE
Alketa DANI

Alketa Dani


REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20210308161239673
Data e Rezultatit te Kerkimit: 08.03.2021
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 4:12:39PM
Lloji i Kerkimit: D-400-314-838
Numri i Dokumentit:
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

GENC NUREDIN ETHEMI
BELLE VUE SH.P.K.



Ado

[Handwritten signature]